

VENDIM
Nr. 490, datë 1.8.2012

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT DHE
INSTAT-IN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 17 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në programin buxhetor 04220 “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”, t’i zbritet nga shpenzimet e personelit fondi prej 7 766 000 (shtatë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekësh.

2. INSTAT-it, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në programin buxhetor “Veprimtaria statistikore”, t’i shtohet në shpenzimet e personelit fondi prej 7 766 000 (shtatë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekësh.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, INSTAT-i dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha